

Në bazë të nenit 36, pragrafi 1 pika 15 nga Ligji për vetëqeverisje lokale („Gazeta zyrtare e RM-së,, nr.05/2), dhe neni 14 i Ligjit për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave („Gazeta zyrtare e RM, nr.201/15),Këshilli i Komunës së Zhelinës në mbledhjen e mbjatur me\_\_\_\_\_2020,miratoi :

### ***Propozim- PLANI AKCIONAL***

#### ***Për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave***

***2021/2022***

#### **1. Hyrje**

Komuna e e Zhelinës gjendet në pjesën perendimore të Republikës së Maqedonisë Veriore. Komuna e Zhelinës përfshin hapësirë prej 199 km<sup>2</sup> dhe sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2002 jetojnë 24.390 banorë. Përfshirja e të dy gjinive është gati e barabartë, d.m.th. 50 %.

Këshilli i komunës për mandatin e viteve 2017-2021 përbëhet prej 19 këshilltarëve prej të cilave 6 janë këshilltare femra, d.m.th. 31.7 %.

Pjesëmarrja e femrave këshilltare në Këshillin e komunës në ciklet e mëparshme elektorale është paraqitur me sa vijon:

Përbërja e Këshillit të komunës 2009-2013

Gjithsej: 19 këshilltarë

Gratë në total dhe përqindje 31.7%

Burrat në total dhe përqindje 68.3%

Ndërsa pjesëmarrja e grave në këshillin e komunës së Zhelinës 2001-2005 ka qenë shumë e ulët. Pas futjes së kuotës gjinore për kandidatë në zgjedhjet lokale (Ligji i zgjedhjeve lokale i 2004) pjesëmarrja e grave këshilltare në këshillin e komunës së Zhelinës shënon trendin pozitiv, numri i grave të zgjedhura rritet, por jo mjaftueshëm.

Zgjedhjet lokale në vitin 2009 rezultuan 6 gra të zgjedhura këshilltare, e në vitin 2013 - 6 gra të zgjedhura. E gjithë këtë e mundësoi modeli zgjedhorë dhe përcaktimi ligjor i renditjes së kandidatëve në listat zgjedhore.

Kur bëhet fjalë për komisionin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave në Këshillin e Komunës së Zhelinës, përpjkejet për themelimin e këtij komisioni datojnë nga viti 2006. Në fakt, që nga viti 2006 ka nisur ngritja e kapaciteteve të nevojshme njerëzore dhe institucionale për themelimin dhe funksionimin e Komisionit për mundësi të barabarta.

Koordinatori/ja për mundësi të barabarta të grave dhe burrave në komunën e Zhelinës është e përcaktuar nga rradhët e administratorëve shtetëror. Për të cilën është e nevojshme të përcaktohet në Sistematizimin e vendeve të punës me obligime përkatëse të drejtim të nxitjes dhe avancimit të mundësive të barabarta të grave dhe burrave në komunë.

Mund të konkludojmë se mekanizmat institucional për avancimin e raporteve gjinore në komunën e Zhelinës (në pajtim me Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave) në formë të Komisionit të mundësive të barabarta të grave dhe burrave dhe të koordinatorit/es për mundësi të barabarta janë vendosur, por ende nuk i realizojnë obligimet e veta në drejtim të nxitjes dhe avancimit të mundësive të barabarta të grave dhe burrave në komunë.

## **2. Procesi i hartimit**

Duke marrë disa përvoja ,Komuna e Zhelinës në fillim të vitit 2019 iu rek hartimit të Planit lokal aksional për barazi gjinore dhe filloi me planifikimin e masave dhe aktiviteteve për avancimin e barazisë gjinore në komunë.

### **3. Objektivi, qëllimet strategjike dhe aktivitetet**

**Objektivi i përgjithshëm: Aavancimi i barazisë gjinore në komunën e Zhelinës**

#### **Qëllimet strategjike dhe aktivitetet:**

**Objektivi 1:** Përfshirja e qasjes gjinore në krijimin e politikave lokale dhe buxhetit:

*1.1. Futja e konceptit të buxhetit kompetent gjinor në komunë:*

*1.1.1. Punëtori për buxhet kompetent gjinor;*

*1.1.2. Përfshirja e masave gjinore në programet sektoriale;*

*1.1.3. Përgatitja e buxhetit kompetent gjinor për vitin 2021/2022;*

*1.2. Përforcimi i kapaciteteve të administratës komunale, drejtuesëve të sektorëve dhe këshilltarëve për politikën përgjegjëse gjinore;*

*1.3.1. Përgatitje për miratimin e listës së indikatorëve gjinor sipas programeve dhe raporteve ;*

*1.3.2. Revizioni i procedurave të brendshme (rregulloreve dhe kritereve) për ndarjen e mjeteve dhe mbështetjen e organizatave joqeveritare.*

**Objektivi 2:** Parandalimi dhe pengimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe sigurimi i sitemit të mbrotjes së grave viktime të dhunës në bashkëpunim e organet përkatëse:

*2.1. Bashkëpunimi dhe mbështetja e vazhdueshme të shërbimeve aktuale për gratë viktime të dhunës-Qendra për ndihmë juridike pa pagesë.*

*2.2. Organizimi i fushatës informative për format e dhunës ndaj grave, parandalimi dhe sistemi i mbrotjes dhe mbështetjes.*

**Objektivi 3:** Përforcimi ekonomik i grave në komunën e Zhelinës.

- 3.1. Përparimi i bashkëpunimit ndërmjet APRM dhe pushtetit lokal për implemtimin e masave aktive për punësim.
- 3.2. Organizimin e trajnimeve dhe mbështetje për të filluar punë në biznesin e vogël dhe përfshirje në tregun e punës me theks të veçantë si komunë rurale.
- 3.3. Organizimi i panairove/prezantimi i të arriturave të biznesit së grave.

#### **4. Plani i implementimit**

Për implementimin e Planit lokal aksional përgjegjëse do të jetë komuna e Zhelinës, Komisioni për mundësi të barabarta, koordinatori/ja, ndërsa do të përfshihen edhe institucionet e interesuar, partnerët dhe organet, si dhe organizara joqeveritare, ekspert të jashtëm dhe mediumet.

#### **5. Monitorimi dhe valorizimi**

Për monitorim dhe valorizim do të angazhohen të punësuarit në administratën komunale të cilët së bashku me KMB dhe koordinatorin/en për mundësi të barabarta do të ndjekin ecuritë dhe dinamikën e realizimit dhe do të japin propozime për ndryshime të domosdoshme eventuale në drejtim të plotësimit të objektivave të parashtruara, koordinatori/ja do të paraqesë raporte të rregullta për çdo aktivitet të realizuar. Në pjesën e valorizimit do të përfashihen edhe bashkëpunëtorë të jashtëm.

## 6. Mjetet financiare

Realizimi i aktiviteteve do të sigurohet me mjete financiare nga :

- Buxheti i komunës së Zhelinës
- Mjete nga projekte ndërkombëtare, donacione të huaja dhe nga ambasadat
- Projekte dhe programe të ndryshme të BE

Plani Aksional hyn në fuqi ditën e shpalljes në „Flertoren zyrtare të komunës së Zhelinës,,.

Nr. \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_2020  
Zhelinë

Këshilli i komunës së Zhelinës  
Kryetar,  
Liridon Useini